

**V E N D I M**  
**P Ë R**

**KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, pika 4, 35 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2014-2015, janë 365, të ndara si më poshtë vijon:

a) Kuota për kandidatët brenda territorit të vendit	340;
b) Kuota për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet jashtë kufijve të vendit	20;
c) Kuota për transferime	5.

2. Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen si më poshtë vijon:

a) Kuota të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë	185;
b) Kuota të mbuluara nga Ministria e Drejtësisë	14;
c) Kuota të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes	15;
ç) Kuota të pambuluara nga Ministria e Punëve të Brendshme	1;
d) Kuota të pambuluara	125.

3. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata të ciklit të tretë të studimeve me kohë të plotë, të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve me kohë të plotë, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, sipas programeve të studimit, të pasqyruara në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi. Këto kuota rishpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe nga prefekturat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, aplikojnë direkt në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe u nënshtrohen të njëjtave procedura konkurrimi si dhe kandidatët shqiptarë brenda territorit të vendit. Pranimi i tyre në programin përkatës të studimit bëhet bazuar në kriterin e meritës, duke respektuar kuotat për këtë kategori kandidatësh.

6. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur edhe në kërkesën e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studenti transferohet nga programe specializuese afatgjata të akredituara, të ofruara nga institucione të akredituara dhe licencuara në vendin përkatës, në programe të njëjta ose të ngjashme specializimi afatgjata, deri në vitin e dytë të programit përkatës specializues.

7. Aplikojnë për programe studimi specializuese afatgjata të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.

8. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit, rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

9. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

10. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë, në llogarinë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, 30% të tarifës vjetore të shkollimit. Këstet e tjera arkëtohen sipas rregullores së miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

11. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

12. Fakulteti që mbulon programin specializues afatgjatë siguron studentët për përgjegjësinë profesionale ndaj palëve të treta dhe për shëndetin e tyre, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e

mjekësisë, përpara fillimit të programit specializues dhe në vijim, në çdo fillim viti akademik, duke nisur nga data e skadencës së policës së lidhur një vit më parë.

13. Studentët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, lidhin kontrata, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku përcaktohen detyrimet mes palëve si dhe penalitetet, në rastet e mosrespektimit të tyre. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe i bëhen të ditura kandidatit para hapjes së procesit të aplikimeve.

14. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, një shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pa efekte buxhetore shtesë.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**  
**ED I R A M A**